



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR
PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË PROVIGJONEVE TEKNIKE TË SIGURIMIT TË
DETYRUESHËM NË SEKTORIN E TRANSPORTIT

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 110, datë 28.07.2011
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 142, datë 29.10.2012
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 18, datë 28.02.2013
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 15, datë 20.03.2015
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 14, datë 15.02.2019

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje, është përcaktimi i nivelit të provigjoneve teknike, përmbajtjes së bazës teknike të të dhënave, metodikave për përlllogaritjen e provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të **nenit 14, pika 2**, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, dhe të nenit 10, të Ligjit nr. 10 076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar.

Neni 3
Përkufizime

Termat janë përdorur në këtë rregullore me kuptimet e mëposhtme:

1. “Autoriteti” është Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

2. “Shoqëria” është shoqëria e sigurimit të licencuar nga Autoriteti për të ushtruar 2 veprimtarinë e sigurimeve.
3. “Primi i sigurimit”, ose “Primi” ose “tarifa e primit” është shuma që paguhet nga i siguruari me t.v.sh., ose nga një person që vepron në emër të tij tek siguruesi, me qëllim sigurimin ndaj një rreziku të përcaktuar në kontratën e sigurimit, sipas rregullave të përcaktuara në këtë kontratë.
4. “Primi i rrezikut/ i pastër” është pjesa e primit të sigurimit të vlerësuar (i) për të mbuluar dëmet sipas parashikimeve të përcaktuara në kontratën e sigurimit dhe (ii) për të financuar kontributin e shoqërisë së sigurimit në fondin e kompensimit, sipas parashikimeve të nenit 45 të Ligjit nr. 10 076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.
5. 5.* “Ngarkesa mbi primin e rrezikut” përfshin vlerën e shpenzimeve të lidhura me policën e sigurimit, fitimin e vlerësuar nga shoqëria, si dhe faktorë të tjerë të rëndësishëm për vlerësimin e primit të sigurimit.
6. * “Niveli minimal i provigjonit teknik të primit të pafituar” është niveli i provigjonit teknik të primit të pafituar i llogaritur nga Autoriteti.
7. “Aktuari i autorizuar” është personi i autorizuar nga AMF, sipas parashikimeve të **nenit 4, pika 5 dhe nenit 222**, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.
8. “Shoqata e Aktuarëve” është shoqata profesionale e aktuarëve të Shqipërisë e regjistruar në Gjykatën e rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. 2323, datë 15.07.2008.
9. “Baza e të dhënave” ose “Baza teknike” është tërësia e treguesve statistikorë dhe supozimeve aktuariale, ekonomike, demografike, financiare, etj, të përdorura në llogaritjet aktuariale.

Neni 4

Përcaktimi i nivelit të provigjonit teknik i primit të pafituar

1. Provigjoni teknik i primit të pafituar, përcaktohet si më poshtë:
 - a. Shoqëria e sigurimit llogarit primin e rrezikut për produktin e sigurimit të detyrueshëm motorik dhe e dërgon atë në Autoritet brenda datës 10 mars të çdo viti;
 - b. Autoriteti, mbi bazën e të dhënave të shkronjës “a”, llogarit primin e rrezikut në nivel tregu dhe e publikon atë brenda datës 31 mars;
 - c. Shoqëria e sigurimit llogarit nivelin e provigjoneve teknike të primit të pafituar të sigurimit të detyrueshëm motorik, duke u kujdesur që njëherazi:
 - i. Provigjionet teknike të llogariten për çdo policë sigurimi;
 - ii. Vlera e provigjoneve teknike të jetë të paktën sa vlera më e lartë midis primit të rrezikut të llogaritur nga vetë shoqëria e sigurimit sipas shkronjës “a” dhe primit të rrezikut në nivel tregu të llogaritur nga Autoriteti sipas shkronjës “b”.
2. Provigjoni teknik i dëmeve dhe i primeve llogaritet sipas përcaktimeve të Rregullores së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare “Mbi bazat, metodat e llogaritjes si dhe mënyrat e mbajtjes së provigjoneve teknike të sigurimit të Jo-Jetës”.

3. Autoriteti verifikon çdo tre muaj nivelin të provigjoneve teknike të detyrueshme për tu zbatuar nga çdo shoqëri sigurimi.

Neni 5

Bazat e të dhënave për hartimin e tabelave të primit të rrezikut

1. Në hartimin e tabelave të primit të rrezikut, duhet të merren parasysh një bazë të dhënash të tregut për një periudhë që përfshin të paktën 5 vitet e fundit. Baza e të dhënave duhet të përfshijë edhe të dhënat për dëmet e regjistruara për llogari të fondit të kompensimit në periudhën që merret në shqyrtim.
2. *Baza e të dhënave të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të përmbajë specifikimet dhe detajet e mëposhtme:
 - a. Vlerën e dëmeve të ndodhura (kostoja në çdo vit) si dhe vitet e përdorimit të automjetit, të cilat duhen specifikuar dhe të jepen të ndara për çdo kategori automjesh.
 - b. Vlerën e dëmeve të ndodhura, specifikuar si më lart, në të cilën do të përfshihen vlera e dëmeve të paguara si dhe vlera e dëmeve pezull sipas çdo viti aksidenti, duke përfshirë dëmet me vlerë më të mëdha se 10 milionë lekë.
 - c. Numrin e dëmeve të ndodhura, në çdo vit aksidenti, në të cilën do të përfshihen numri i dëmeve të paguara si dhe numri i dëmeve pezull, duke përfshirë dëmet me vlerë më të mëdha se 10 milionë lekë.
 - d. Vlerën dhe numrin e dëmeve të ndodhura por ende të pa raportuara (IBNR), sipas çdo viti aksidenti, që priten të raportohen në të ardhmen.

Informacione shtesë që duhet të ofrohen janë:

- a. Shpërndarja territoriale e policave të lëshuara dhe dëmeve të ndodhura.
 - b. Numri dhe vlera e dëmeve të përfshira në proceset gjyqësore lidhur me trajtimin dhe vlerësimin e dëmit.
 - c. Elementë të tjerë që mund të përdoren në procesin e vlerësimit aktuarial të primit të rrezikut.
3. Hartimi i tabelave dhe vlerësimi i primit të rrezikut kryhet sipas metodave të njohura aktuariale që përfshijnë edhe analizën e ndikimit të faktorëve ekonomikë dhe financiarë të përgjithshëm dhe makro, si dhe:
 - a. Ekspertizën për produktin dhe vlerësimet aktuariale;
 - b. Eksperiencën e produktit në tregun shqiptar të sigurimeve;
 - c. Tendencat e tregut ndërkombëtar të risigurimeve dhe bashkëpunimi me risiguruesit përkatës.

Neni 6

Raporti aktuarial

Tabelat e primit të rrezikut shoqërohen me një raport aktuarial, i cili përmban:

- a. Vlerësime mbi profilin e rrezikut të çdo produkti dhe tendencat e shfaqura;
- b. Vlerësime për dëme të mëdha dhe tendencat;
- c. Metodën statistikore të përdorur në llogaritjen e demit mesatar të rregulluar;
- d. Frekuencën e dëmeve të rregulluara;
- e. Normën e pritshme të inflacionit të përgjithshëm dhe atij të produktit;
- f. Koeficientin e pritshëm për fondin e kompensimit;
- g. Metodatat statistikore dhe aktuariale të përdorura në vlerësimin e çdo elementi tjetër të primit të rrezikut, përfshirë këtu gjykimet mbi efektin moral, biologjik dhe ekzistencial.

Neni 7

Shoqata e aktuarëve

1. Shoqata e aktuarëve me kërkesë të Autoritetit mund të hartojë tabelat e primit të rrezikut për produktet e sigurimit të detyrueshëm. Shoqata e aktuarëve bashkëpunon me Autoritetin dhe ka rol këshillues.
2. Drejtoria e Administrimit të Riskut në AMF, pasi shqyrton e këshillohet me materialet e Shoqatës së Aktuarëve, harton tabelat e primit të rrezikut për produktet e sigurimit të detyrueshëm dhe Bordi i Autoritetit i miraton ato.

Neni 8

Detyrimi për njoftim

1. Shoqëria e sigurimit njofton Autoritetin 10 ditë përpara fillimit të zbatimit të tarifave të primeve të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit.
2. *Shoqëria e sigurimit së bashku me tabelat e tarifave të primeve për produktet e sigurimit të detyrueshëm, depoziton në Autoritet bazat teknike të përdorura, metodikën e përdorur për llogaritjen e primit të rrezikut, si dhe materialet mbështetëse.

Neni 9*

Tarifat e primit të sigurimit

1. Primi i sigurimit përbëhet nga elementët e përcaktuar **në nenin 87**, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014. Shoqëria e sigurimit i përcakton vetë tarifat e primit për produktet e sigurimit të detyrueshëm motorik dhe njofton Autoritetin për tarifat e reja dhe çdo ndryshim në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

2. Autoriteti shprehet brenda 10 ditëve nga data e depozitimit të tarifave, si dhe njofton Qendrën e Informacionit për fiksimin e këtyre tarifave deri në depozitim të tarifave të reja. Autoriteti ka të drejtë të kërkojë nga shoqëria çdo informacion mbështetës, që e gjykon të arsyeshëm, në argumentimin e përllogaritjes së tarifave. Në rast se konstatohet se bazat e të dhënave për hartimin e tabelave të primit të rrezikut nuk janë të sakta apo nëse aktuari i shoqërisë nuk ka përdorur metodat e njohura aktuariale në procesin e vlerësimit të primit të rrezikut, referuar Nenit 5 të kësaj Rregullore, Autoriteti ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë së sigurimit të kryejë sërish vlerësimet aktuariale të primit të rrezikut konform kërkesave ligjore dhe të ri depozitojë në Autoritet tabelat e reja të tarifave të primeve për produktet e sigurimit të detyrueshëm.
3. Në rast se shoqëria e sigurimit nuk njofton në Autoritet tarifat e ndryshuara, në Qendrën e Informacionit mbeten të fiksuara tarifat e mëparshme. Në rast se shoqëria zbaton tarifa të primit të sigurimit të detyrueshëm, më të ulëta se primi i rrezikut dhe nëse konstatohet se shoqëria e sigurimit jep sinjale për ulje të likuiditetit, si dhe rrezikon përmbushjen e rregullave të Menaxhimit të Rrezikut në përputhje me Ligjin nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Autoriteti merr masat konform dispozitave ligjore.

Neni 10

Publikimi i primeve

1. Shoqëria publikon primet e rrezikut si dhe primet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit në faqen e saj të internetit dhe i mban ato të afishuara në faqe gjatë gjithë periudhës së zbatimit.
2. Tabelat me primet e miratuara të sigurimit duhet të qëndrojnë të afishuara në çdo pikë të shitjes së shoqërisë, gjatë gjithë periudhës së zbatimit të tyre.

Neni 11

Hyrja në fuqi

1. Rregullorja nr. 75, datë 28.08.2009 “Për primet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, shfuqizohet.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 10 455, datë 21.07.2011 për disa ndryshime në Ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar.

KRYETAR
Elisabeta GJONI